

LIGJ
Nr.10 217, datë 21.1.2010

PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9875, DATË 14.2.2008
“PËR METROLOGJINË”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9875, datë 14.2.2008 “Për metrologjinë”, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Neni 61 “Ankimimi” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 61
Ankimimi

Kundër vendimit të nxjerrë nga inspektori metrolog mund të bëhet ankim në komisionin e ankimimit, të kryesuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të këtij komisioni përcaktohen në rregulloren e miratuar nga ministri përgjegjës për ekonominë.”.

Neni 2

Në nenin 65 “Shqyrtimi dhe ankimi”, pikat 2 dhe 3 ndryshohen si më poshtë:

“2. Kundër vendimit të dënimit me gjobë, të dhënë nga inspektori metrolog i Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, mund të bëhet ankim, në përputhje me ligjin e përmendur në pikën 1 të këtij neni.

3. Kundër vendimit të komisionit të ankimimit mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr.7697, datë 7.4.1993 “Për kundërvajtjet administrative”, të ndryshuar.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6395, datë 4.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi